



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit, në mbështetje të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të nenit 15 të Rregullores së Kuvendi, në mbledhjen e mbajtur më 4 prill 2022, pasi e shqyrtoi Planin strategjik të Kuvendit për periudhën 2022-2025, mori këtë:


V E N D I M

Miratohet Plani Strategjik i Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2022–2025.

Nr. 08-V- 150

Prishtinë, 04.04.2022

Glauk KONJUFCA


Kryetar i Kuvendit

Vendimi dhe Plani strategjik u dërgohen:

- Deputetëve të Kuvendit
- Grupeve parlamentare,
- Administratës së Kuvendit dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Plani Strategjik i Kuvendit të Republikës së Kosovës
2022-2025

1. Parathënie nga Kryetari i Kuvendit.....	4
2. Fjala hyrëse e sekretarit të Përgjithshëm.....	5
3. METODOLOGJIA	5
4. NDËRTIMI i një Kuvendi të fuqishëm demokratik.....	7
5. Vizioni për të ardhmen.....	7
6. Misioni	7
7. Ndërtimi MBI vlera dhe parimet thelbësore	8
8. Sfidat dhe mundësitë.....	8
9. Objektivat dhe fokusi strategjik	9
10. Objektivat strategjike	9
11. Planet e KUVENDIT për realizimin e punës.....	11
Udhërrëfyese drejt vizionit	12
Mobilizimi i resurseve	13
Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi	13
12. Shtojcat	13
Plani i veprimit	13

Lista e shkurtesave:

KRK–	<i>Kuvendi i Republikës së Kosovës</i>
OSHC–	<i>Organizatat e Shoqërisë Civile</i>
ECPRD–	<i>Qendra Evropiane për Hulumtime Parlamentare dhe Dokumentim</i>
PARS –	<i>Sistemi për Vlerësimin dhe Shqyrtimin e Performancës</i>
GZMVPS -	<i>Grupi për Zbatimin, Monitorimin dhe Vlerësimin e Planit strategjik</i>
MSA –	<i>Marrëveshja e Stabilizim- Asociimit</i>
OSBE-	<i>Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë</i>
OZHQ	<i>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm</i>
TeR-	<i>Termet e Referencës</i>
UNDP Kosovë-	<i>Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Kosovë</i>
NDI-	<i>Instituti Ndërkombëtar Demokratik</i>
TIK-	<i>Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit</i>

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kuvendi, që nga themelimi i tij në vitin 2001, ka ndërmarrë një sërë hapash shumë të rëndësishëm në rrugën drejt avancimit të legjislativit, në një organ efikas dhe demokratik që t'ju shërbejë qytetarëve të Kosovës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Rregullorja e Kuvendit, theksojnë qartë rolin, funksionin dhe kompetencat e Kuvendit, në kontekst të përbërjes, procesit legjislativ, mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar, si dhe përfaqësimit të qytetarëve.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, luan një rol qendror në sistemin e qeverisjes të Republikës së Kosovës.

Një Kuvend efikas do të rezultojë në përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimit në Kosovë, dhe pasqyra e Planit strategjik do të luajë një rol thelbësor në këtë proces.

Plani Strategjik paraqet vizionin dhe drejtimet kryesore strategjike për të udhëhequr Kuvendin gjatë katër viteve të ardhshme 2022-2025, për ndërtimin e një Kuvendi të fuqishëm demokratik. Plani përshkruan objektivat dhe aktivitetet që do të avancojnë kulturën parlamentare dhe do të përmirësojnë mekanizmat e Administratës së Kuvendit. Plani në vete përmban vizionin për të ardhmen, misionin dhe parimet e qarta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, si dhe një sërë objektivash strategjike që synohen të arrihen nga Kuvendi gjatë periudhës katërvjeçare.

Kuvendi, komisionet dhe deputetët do të vazhdojnë të miratojnë ligje cilësore, të cilat do t'i paraprijnë integritetit evropian të Kosovës, mbështetjes së zhvillimit të ekonomisë dhe rritjes së mirëqenies, sidomos në kushtet e vështirësive që janë krijuar nga pasojat e pandemisë Covid-19.

Qëllimi ynë është që dinamizmi dhe energjitë me të cilat Kuvendi dhe deputetët e përballuan e po e përballojnë këtë fatkeqësi natyrore, të shndërrohet në vlerë të përhershme.

Forcimi i kontrollit parlamentar ndaj Qeverisë dhe mbikëqyrja dhe mbështetja e institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, si mbrojtës të interesit publik dhe qytetar, do të jenë gjithashtu një prioritet i Kuvendit edhe në vitet që vijnë.

Këto sfida të vështira, por fisnike, pjesë e përgjegjësive dhe kontributit shtetëror të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kërkojnë një trupë ligjvënëse energjike e të kulturuar, të përgjegjshme e produktive, të përkushtuar e llogaridhënëse. Republika e Kosovës ka nevojë për një Kuvend të fortë, përfaqësues, efektiv dhe për njerëzit, të mbështetur në vlerat tona më të arritura politike, shoqërore, njerëzore e shtetërore.

Ekzistojnë një sërë parakushtesh që ky plan strategjik të bëhet realitet, të tilla si marrëdhënia konstruktive ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë, përfshirja e plotë e Administratës së Kuvendit, përkrahja nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare partnere të Kuvendit.

Periudha katërvjeçare e planit, nënkupton se plani do të shkojë përtej zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme. Ky fakt i shërben fuqizimit të këtij plani për zhvillimin e institucionit parlamentar, sepse nevoja për fuqizimin dhe modernizimin e legjislativit mbetet e vazhdueshme, pavarësisht se cila parti politike e ka shumicën.

Kuvendi është i përkushtuar në pjesëmarrjen tij në iniciativat rajonale, evropiane dhe globale, në zbatimin e objektivave universale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke balancuar aspektet mjedisore, sociale dhe ekonomike të agjendës për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), në mbikëqyrjen e zbatimit të konventave dhe deklaratave, që janë burim dhe pjesë e Kushtetutës sonë, duke respektuar dhe duke iu përmbajtur parimeve bazike për të drejta të njeriut dhe masave afirmative për integrim gjinor, si nevojë për përmbushjen e detyrimeve tona, përmes shfrytëzimit efikas dhe efektiv të të gjitha burimeve në dispozicion të Kuvendit Kosovës.

I ftojmë të gjitha institucionet qeveritare, të gjithë qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë, të bashkëpunojnë me Kuvendin e Republikës së Kosovës për zhvillimin dhe avancimin e mëtejshëm të demokracisë për të mirën e të gjithëve.

Glauk Konjufca,

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Në rrugëtimin tim 15 vjeçar, ky është dokumenti i tretë strategjik për organizimin më të mirë të punës së Kuvendit, përcaktimit të prioritetëve dhe njëkohësisht krijimit të një kulture të mëtejme strategjike.

Korniza e këtij plani është edhe më e avancuar, e menduar mirë e më larg, e përcaktuar me mundësi të adaptimit me vite, krahas ndryshimeve që mund të ndodhin edhe në vitet e ardhshme.

Plani ka një natyrë edhe teknike edhe politike, sepse Kuvendi është institucion i tillë, për nga natyra e vendimmarrjes politike, argumentimi profesional është i pashmangshëm. Shpeshherë në grupe punuese mund ta gjesh veten duke lexuar mendime të deputetëve dhe përgjigjen që duhet dhënë.

Kjo natyrë komplekse e punës e bën Kuvendin dhe administratën pjesë integrale të të gjithë procesit, përveç vendimmarrjes.

Shërbimet e Kuvendit tashmë kanë dëshmuar se ka profesionalizëm, dhe në këto dy vitet me ballafaqim me pandeminë COVID 19, me organizim të punës me prezencë fizike, me organizim të punës nga distanca, asnjëherë, asnjë aktivitet nuk ka mbetur pa u realizuar.

Me gjithë arritjet të cilat janë bërë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në përmbushjen e detyrimeve të tij, objektivat, aktivitetet dhe rezultatet që janë paraparë në këtë plan, kanë të bëjnë me një pasqyrë më të detajuar dhe rezultate të matshme të trupave profesionale dhe administrative në funksionalizimin, forcimin dhe institucionalizimin e punës së Kuvendit.

Plani Strategjik i Kuvendit të Republikës së Kosovës 2022-2025, përfshinë rolin dhe përgjegjësitë e Administratës së Kuvendit për ofrimin e shërbimeve në mënyrë më cilësore, të ndihmojë deputetët për të përmbushur funksionet ligjore, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese, në mënyrë më konkrete.

Administrata e Kuvendit është dëshmitare e zhvillimit të përgjithshëm të këtij institucioni përgjatë njëzetë viteve të fundit, në ngritjet funksionale e strukturore, që është ofruar përmes ndihmës dhe asistencës së partnerëve ndërkombëtarë, si në zhvillimin e drejtorive dhe njësisve të reja, ashtu edhe në hartimin, planifikimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive sektoriale.

Prandaj, administrata është e përkushtuar që objektivat e Planit Strategjik 2022-2025, bashkë me planin e veprimit, t'i zbërthejë në plane vjetore të punës për administratën si tërësi dhe në plane specifike vjetore të drejtorive, si standard për përmbushjen e agjendës parlamentare, si parakusht për integrim në familjen evropiane.

Administrata do të themelojë edhe Grupin për Zbatimin, Mbikëqyrjen dhe Vlerësimin e Planit Strategjik(GZMVPS), i cili do të sigurojë vazhdimësinë e zbatimit të planit dhe raportimin e rregullt tremujor për arritjen e rezultateve të parapara.

Si sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit, dhe në emër të administratës, falënderoj të gjithë pjesëmarrësit në hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2022-2025.

Ismet Krasniqi,

Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2022-2025 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij është bazuar, *ndër të tjera*, në:

- Analizën e plotë të mjedisit veprues të brendshëm dhe të jashtëm të institucionit që ndikon në realizimin e misionit dhe zhvillimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, realizuar me nivelin drejtues politik dhe administrativ të Kuvendit. Është realizuar duke evidentuar pikat e forta dhe të dobëta, mundësitë dhe rreziqet, të cilat u reflektuan në përcaktimin e fushave me prioritet të Planit Strategjik, qëllimit dhe objektivave strategjike, si dhe masave konkrete të konceptuara në planin e veprimit për përmbushjen e objektivave strategjike.
- Planin Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2016-2020 dhe në mësimet e nxjerra nga kjo periudhë.
- Angazhimet dhe standardet ndërkombëtare në lidhje me funksionimin e parlamenteve, si dhe angazhimet dhe detyrimet që burojnë direkt për Kuvendin nga aktet dhe raportet e monitorimit të organizmave ndërkombëtarë, ku Kosova është palë.
- Konkluzionet dhe rekomandimet e dhëna për Kuvendin në aktet e institucioneve të BE-së për Kosovën, në aktet e strukturave të përbashkëta BE-Kosovë, si dhe në raportet e ekspertëve të BE-së, në kuadër të zbatimit të projektit të binjakëzimit.
- Transparencën, gjithëpërfshirjen dhe partneritetin e pjesëmarrësve në proces, duke filluar nga Sekretari i Përgjithshëm, përfaqësues të grupeve parlamentare, kabineti i Kryetarit të Kuvendit, Administrata Kuvendit, eksperti i angazhuar nga GIZ-i, grupet e interesit që bashkëpunojnë me Kuvendin, të përfshirë drejtpërdrejt apo tërthorazi në Planin Strategjik.
- Qasjen gjinore të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për zbatimin e tij, duke reflektuar parimet evropiane të integritimit gjinor, si dhe duke e harmonizuar me Programin e Veprimit “Për një Parlament të ndjeshëm gjinor”, si dokumentin kuadër që do të udhëheqë punën e Kuvendit në aspektin e integritimit dhe barazisë gjinore.

NDËRTIMI I NJË KUVENDI TË FUQISHËM DEMOKRATIK

Plani Strategjik paraqet vizionin dhe drejtimet kryesore strategjike për të udhëhequr Kuvendin gjatë katër viteve të ardhshme 2022-2025. Plani paraqet një kornizë të përditësuar për përmirësimin dhe modernizimin e sistemeve dhe proceseve për një qeverisje efektive dhe demokratike nga Kuvendi, si dhe për zhvillimin e kapaciteteve të deputetëve të zgjedhur dhe Administratës së Kuvendit.

Plani do të ndihmojë për ta drejtuar Kuvendin përmes sfidave me të cilat do të përballlet në vitet e ardhshme dhe ta përgatisë atë plotësisht për të ardhmen, në mënyrë që të punojë në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ky plan mbështetet në arritjet e Planit Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2016-2020 dhe në mësimet e nxjerra nga kjo periudhë.

Duke qenë i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli dhe duke përfaqësuar të gjithë qytetarët, Kuvendi është institucioni më i lartë përfaqësues dhe legjislativ në Republikën e Kosovës. Duke ushtruar kompetencat në përputhje me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ai debaton çështje me rëndësi shtetërore, miraton legjislacionin dhe i kërkon Qeverisë llogari. Procedurat zhvillohen në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, dhe sipas agjendës së propozuar nga Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim me Qeverinë, me kryetarët e grupeve parlamentare dhe me kryetarët e komisioneve parlamentare. Funkcioni legjislativ dhe mbikëqyrës ushtrohet përmes organeve punuese të Kuvendit, që përbëhen nga komisionet e përhershme, komisionet funksionale dhe komisionet ad hoc.

Cilësia e qeverisjes së përgjithshme dhe e demokracisë së Kosovës mund të përmirësohet duke vazhduar me forcimin e mëtejshëm të funksioneve themelore legjislative, mbikëqyrëse, dhe përfaqësuese të Kuvendit.

Qasja e Kuvendit është ambicioze, ku kërkohet punë e përbashkët efektive në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës për të arritur rezultatet dhe ndryshimet që përmirësojnë jetën dhe mirëqenien e sotshme dhe atë të brezave të ardhshëm.

VIZIONI PËR TË ARDHMEN

Kuvendi punon për qytetarët e Republikës së Kosovës në vazhdimësi për të bërë ndryshime pozitive në jetën e tyre.

Vizioni i Kuvendit: "Kuvendi i Kosovës është promotor i reformave në shoqëri, duke u fokusuar në demokraci, transparencë në pajtim me standardet evropiane.

MISIONI

Deklarata e Misionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën [2022-2025](#):

"Kuvendi do të zhvillojë më tej sistemet dhe proceset që mbështesin vlerat demokratike të bazuara në sundimin e ligjit, që i përgjigjen nevojave dhe aspiratave të qytetarëve, të cilat sigurojnë legjislacion të duhur, të drejtë e efikas, mbikëqyrje efektive dhe llogaridhënie".

NDËRTIMI MBI VLERA DHE PARIMET THELBËSORE

Qasja strategjike e punës zhvillohet në bazë të vlerave të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, drejtësisë, barazisë dhe të drejtave të njeriut.

Llogaridhënës Kryerja e punës me integritet, ndershmëri dhe përgjegjësi	Konsultues Mbështetja e punës në diskutimin e fakteve, rekomandimeve dhe sugjerimeve	Bashkëpunues Ndërtimi i raporteve me të gjithë për të funksionuar si një ekip
Transparent I hapur, i qasshëm dhe konsistent në punë	<i>Kuvendi i Republikës së Kosovës</i> <i>Duke punuar së bashku përmes vlerave të përbashkëta si një ekip</i>	Komunikues Ndarja e punës dhe rezultateve me të gjitha palët e interesit në shoqëri
I përgjegjshëm Përshtatja ndaj ndryshimit të nevojave në mënyrë proaktive		I paanshëm Pranimi i pikëpamjeve të ndryshme dhe jo gjykuese
I respektueshëm Demonstrimi i respektit dhe profesionalizmit në punë	I pavarur Mbështetja e pavarësisë së Kuvendit në raport me stafin, financat dhe planifikimin e punës	Gjithëpërfshirës Demonstrim i mos-diskriminimit dhe gjithë përfshirjes

SFIDAT DHE MUNDËSITË

Janë pesë sfida dhe mundësi të përbashkëta për të arritur vizionin:

1. Rritja e besimit të qytetarëve në integritetin e Kuvendit;
2. Organizimi dhe menaxhimi efikas i punës në Kuvend, gjatë ushtrimit të funksionit përfaqësues, ligjvënës, zgjedhor dhe mbikëqyrës;
3. Krijimi i kushteve të favorshme për punë për deputetët me hapësirat e nevojshme fizike;
4. Forcimi i marrëdhënieve me palët e interesit, agjencitë dhe institucionet e pavarura;
5. Sigurimi i bashkëpunimit ndërparlamentar dhe ndërkombëtar;
6. Rritja e përfitimeve nga teknologjia informative dhe shërbimet digjitale.

Veprimet e Planit Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës 2022-2025, do të mbështeten dhe do të konsolidohen, ndërsa për të rifreskuar dhe rigjallëruar punën e Kuvendit do të ketë prioritete dhe veprime të reja strategjike.

OBJEKTIVAT DHE FOKUSI STRATEGJIK

Pesë drejtime themelore strategjike për punën e Kuvendit përgjatë periudhës 2022-2025

AJO QË DUAM TË ARRIJMË				
Kuvend i hapur dhe i qasshëm	Kuvend me performancë të lartë	Kuvend demokratik	Kuvend i përkushtuar në diplomaci parlamentare	Kuvend për të ardhmen
ÇFARË DO TË THOTË KJO NË PRAKTIKË				
Përfshirja dhe inkurajimi i publikut dhe shoqërisë civile për t'u angazhuar në Kuvend si forumi kryesor i debatit politik dhe vendimmarrjes	Rritje e demokracisë përfaqësuese dhe ofrim i shërbimeve cilësore nga dhe për deputetët	Hartimi dhe miratimi i legjislacionit cilësor dhe mbikëqyrje efektive e ekzekutivit	Përmirësimi i reputacionit ndërkombëtar të Kosovës, si vend demokratik dhe angazhim aktiv në proceset integruese	Menaxhimi i ndryshimit teknologjik drejt përdorimit të platformave digjitale përmes TIK-ut
ÇFARË DUHET BËRË				
Do të avancohet qytetaria aktive që është e interesuar dhe e angazhuar në punën transparente të Kuvendit përmes komunikimit, fizibilitetit, edukimit, qasjes dhe pjesëmarrjes.	Do të mbështeten aktivitetet e deputetëve në përfaqësimin e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes avancimit të shërbimeve të ofruara nga administrata me përkushtim dhe profesionalizëm	Përmirësimi i procesit legjislativ në Kuvend duke siguruar një shqyrtim dhe cilësi më të mirë të legjislacionit, si dhe do të avancojmë mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare, duke siguruar një kontroll më të mirë të ekzekutivit"	Mbështetje deputetëve të Kuvendit dhe trupave punuese në forcimin e bashkëpunimit ndërparlamentar në nivel rajonal, evropian dhe më gjerë.	Aplikimi i teknologjive bashkëkohore dhe inovative drejt digjitalizimit të shërbimeve që janë gjithnjë e më afër qytetarëve.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivat strategjike përcaktojnë prioritetet dhe një kornizë për shërbim më të mirë. Ato kanë për qëllim të nxjerrin në pah fushat kryesore në të cilat mund të bëhen përmirësime gjatë periudhës 2022-2025, duke u fokusuar në një grup të kufizuar të fushave thelbësore.

Kuvend i hapur në shërbim të qytetarëve	
Fusha e punës	Përshkrimi
Komunikimi	Ngritja e komunikimit, transparencës si dhe qasjes në informatat parlamentare dhe institucionale
Angazhimi	Promovimi dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe i shoqërisë civile
Edukimi	Ofrimi i edukimit më të mirë për qytetarët rreth funksioneve, roleve dhe proceseve të Kuvendit
Qasja	Zgjerimi dhe përmirësimi i qendrës së vizitorëve, qasjes sipas standardeve në hapësirat e Kuvendit, për personat me aftësi ndryshe, zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe avancimi i faqes së internetit
Reputacioni	Përmirësimi i reputacionit të Kuvendit përmes pasqyrit të informatave në mënyrë profesionale. Krijimin e identitetit vizual (brendi)
Rezultati kryesor	Përmirësimin e komunikimit, pjesëmarrjes, qasjes dhe imazhit publik përmes transparencës duke zhvilluar punë edukuese dhe sensibilizuese për Kuvendin në të gjitha proceset

Kuvendit përmes funksionit përfaqësues siguron qasje në informata për të gjitha mediat, duke përfshirë edhe median sociale, në edukimin e qytetarëve për punën dhe mënyrën e funksionimit të Kuvendit.

Zgjerimi dhe përmirësimi i qendrës së vizitorëve do të mundësojë qasje dhe angazhim më të madh të qytetarëve. Në mënyrë të ngjashme, rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile, siguron një urë efektive në mes të qytetarëve dhe Kuvendit. Nëse merren së bashku, këto fusha do të sigurojnë një bazë për forcimin e rolit përfaqësues të deputetëve.

Kuvend me performancë të lartë	
Fusha e punës	Përshkrimi

Mjetet dhe shërbimet	Përmirësimi i planifikimit dhe menaxhimit, përmes miratimit të legjislacionit dhe akteve nënligjore për Kuvendin për t'u siguruar deputetëve, trupave të Kuvendit, dhe Administratës shërbime dhe mjete efikase
Baza e njohurive	Shfrytëzimi i njohurive të fituara nga trajnimet dhe shkëmbim përvojash me parlamentet tjera për të përmirësuar punën në Kuvend
Kapacitetet e ofrimit të shërbimeve	Rritja e njohurive, aftësive dhe kompetencave përmes trajnimit për deputetët dhe stafin administrativ
Kushtet për punë	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i kushteve të punës për deputetët, duke krijuar hapësira – zyre për ta¹ • Kapacitete teknike përfshirë: mjetet e punës, përkrahje profesionale, staf – këshilltar, si dhe përkrahje administrative, përkatësisht me staf administrativ
Puna ekipore	Përmirësimi i komunikimit të brendshëm dhe bashkëpunimit ndërmjet drejtorive
Ngritja e kapaciteteve profesionale të deputetëve	Ngritja e aftësive komunikuese për deputetët, përmes ngritjes së kapaciteteve të gjuhëve të huaja apo atyre zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe aftësimet tjera profesionale sipas identifikimit të nevojave.
Infrastruktura	Modernizimi dhe ngritja e efikasitetit dhe eficiency së ndërtesës, infrastrukturës dhe mjedisit të punës së Kuvendit. Zgjerimi i hapësirave të gjelbra brenda dhe jashtë Kuvendit. Funksionalizimi i qendrës protokolare të Kuvendit të Kosovës në parkun e Gërmisë.
Rezultati kryesor	Forcimi i pavarësisë institucionale, rritja e integritetit të Kuvendit dhe zhvillimi i kapaciteteve të administratës dhe deputetëve, për ofrim më të mirë të shërbimeve

Puna brenda këtij drejtimi strategjik do të forcojë pavarësinë institucionale, do të rrisë integritetin e Kuvendit, do të zhvillojë kapacitetet e administratës dhe do të mundësojë rishikimin e organizimit të strukturës për funksionim më të mirë. Përmes miratimit të legjislacionit për Kuvendin do të mundësohet punë më efikase, efektive të deputetëve dhe trupave punuese të Kuvendit duke funksionuar si një ekip.

Kjo punë do të rezultojë në staf më të trajnuar, përmirësim të administratës, infrastrukturës, shërbimeve profesionale legjislative, shërbimeve hulumtuese, bibliotekës dhe digjitalizimit.

Kuvend demokratik - Duke mbështetur procesin legjislativ dhe mbikëqyrës	
Fusha e punës	Përshkrimi
Sistemet e TI-së për përcjellje të legjislacionit	Zhvillimi i mëtejshëm i platformës - sistemi për përcjelljen e ligjeve (LTS), aplikimi dhe përdorimi i platformave tjera.
Shqyrtimi	Kalendari i aktiviteteve për komisionet, seancës dhe Kryesisë
Këshilla dhe analiza	Përmirësimi i cilësisë së legjislacionit përmes ofrimit të këshillave ligjore të pavarura dhe analizës ligjore për projektligjet për deputetët dhe komisionet
Kapaciteti legjislativ	Organizimi i trajnimeve për deputetë në lidhje me procesin legjislativ me fokus në përmbushjen e agjendës për integrim evropian dhe OZHQ-ve.
Mbikëqyrja parlamentare	Forcimi i rolit mbikëqyrës përmes azhurnimit të mekanizmave të mbikëqyrjes, aplikimit të metodave të reja të mbikëqyrjes dhe forcimin e kapaciteteve të stafit parlamentar.
Rezultati kryesor	Legjislacion cilësor i miratuar përmes një procesi demokratik (konsultimeve me qytetarët dhe grupet e interesit, dhe bazuar në ekspertizën e shërbimeve profesionale, si dhe mbikëqyrje efikase të ekzekutivit në zbatimin e politikave, legjislacionit dhe buxhetit)

Funksioni kryesor legjislativ i Kuvendit të Kosovës është miratimi i ligjeve, rezolutave dhe akteve të tjera të përgjithshme (neni 65 i Kushtetutës). Një funksion tjetër kyç i Kuvendit, është mbikëqyrja e Qeverisë. Përmes këtij drejtimi strategjik ne do të identifikojmë dhe zbatojmë përmirësime në procesin legjislativ në Kuvend, për të siguruar përmirësime në shqyrtimin dhe cilësinë

¹ Është zotim nga Kryesia e Kuvendit dhe Qeveria e Kosovës për të negociuar me ZBE rreth objektit të ish-MPMS

e legjislacionit. Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet procesit të përafrimit me Acquis të BE-së. Përmirësimi i procesit të mbikëqyrjes do të fokusohet në ndikimin dhe efikasitetin e zbatimit të legjislacionit dhe politikave, dhe do të mbështesin kapacitetin e Kuvendit për të shqyrtuar dhe siguruar mbikëqyrjen e politikave buxhetore të Qeverisë në shpenzimin e parasë publike.

Gjatë zbatimit të Planit Strategjik, rol të rëndësishëm do të ketë mbikëqyrja parlamentare e procesit të integritetit evropian.

Kuvend i përkushtuar në diplomaci parlamentare	
Fusha e punës	Përshkrimi
Diplomacia parlamentare	Koordinimi i aktiviteteve të Kuvendit me Presidentin dhe Qeverinë, në aktivitetet ndërkombëtare dhe intensifikimi i marrëdhënieve ndërparlamentare
Procesi i Integritetit në BE	Forcimi i bashkëpunimit të Kuvendit me institucionet e BE-së dhe zbatimi i obligimeve që dalin nga MSA-ja.
Organizatata ndërkombëtare	Sigurimi i pjesëmarrjes dhe anëtarësimit të Kuvendit në organizata dhe nisma rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare
Bashkëpunimi ndërkombëtar	Zhvillimi i partneritetit dhe bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve homologe me parlamentet e vendeve të rajonit dhe më gjerë
Bartja e njohurive	Bashkëpunimi me donatorët ndërkombëtarë për rritjen e kapaciteteve dhe bartjen e njohurive
Rezultati kryesor	Kuvend me diplomaci parlamentare të zhvilluar, i anëtarësuar në organizata dhe nisma rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare

Kosova është vend kandidat potencial për anëtarësim në BE, prandaj roli i Kuvendit në këtë proces është i rëndësishëm. Në vitet e ardhshme, intensifikimi i bashkëpunimit me institucionet e BE-së do të jetë thelbësor për arritjen e qëllimit tonë për anëtarësim në BE.

Kuvend për të ardhmen- menaxhimi i ndryshimit teknologjik	
Fusha e punës	Përshkrimi
Sistemet e TIK-ut	Përmirësimi i sistemeve harduerike dhe softuerike të TIK-ut të Kuvendit
Kapaciteti i TIK-ut	Mbështetja e deputetëve, komisioneve dhe stafit të administratës në përdorimin e TIK-ut dhe e-shërbimeve përmes përkrahjes teknike dhe trajnimit
Shpërndarja e informatave	Rritja e kapacitetit për shpërndarjen e informatave dhe dokumenteve në mënyrë elektronike të deputetët, stafi dhe qytetarët
Ofrimi i e-shërbimeve	Rritja e qasjes dhe përdorimit të shërbimeve elektronike dhe qasje më e madhe e të dhënave të hapura të publikuara
Shkëmbimi i informatave	Përmirësimi i shkëmbimit të informatave me parlamentet e tjera
Rritja e qëndrueshmërisë së objektit	Zbatimi i masave të qëndrueshme në objektin e Kuvendit.
Rezultati kryesor	Bashkëveprim më i madh me qytetarët, menaxhim më i mirë i dokumenteve, publikim me kohë i dokumentacionit dhe përgatitje më efikase e legjislacionit

Ndërtimi i kapacitetit të TIK-ut është një komponentë thelbësore e një institucioni parlamentar efektiv dhe modern. Digjitalizimi i Kuvendit mund të mbështesë fuqishëm dhe të rrisë bashkëpunimin, përfshirjen, pjesëmarrjen dhe hapjen për qytetarët tanë, përmes përdorimit të platformave digjitale të TIK-ut.

PLANET E KUVENDIT PËR REALIZIMIN E PUNËS

Në Shtojcën 'Plani i Veprimit' më poshtë, janë përcaktuar aktivitetet indikative në secilën nga pesë drejtimet kryesore strategjike. Aktivitetet do të rishikohen dhe funksionalizohen më tej përmes Planit Vjetor të Punës së Kuvendit dhe Administratës, i miratuar nga Kryesia e Kuvendit.

UDHËRRËFYESI DREJT VIZIONIT

Do të punohet vazhdimisht në të gjitha drejtimet e këtij Plani Strategjik, për të fokusuar mendjet në vizionin dhe misionin tonë, ne propozojmë që secili prej pesë viteve të ardhshme të ketë një prioritet themelor në kuadër të Planit të përgjithshëm strategjik:

2022:	Viti i qytetarit <ul style="list-style-type: none">- <i>Angazhim më i mirë:</i> Fokusimi në transparencë dhe komunikim më të mirë të punës së Kuvendit në gjithë shoqërinë
2023:	Viti i zyrtarit publik <ul style="list-style-type: none">- <i>Punë më e mirë për dhe nga deputetët:</i> Fokusimi në mbështetjen më të mirë të deputetëve dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit për të ofruar mbështetjen
2024:	Viti i demokracisë <ul style="list-style-type: none">- <i>Legjislacion dhe mbikëqyrje më e mirë:</i> Fokusimi në përmirësimin e proceseve legjislativë, funksionimin e trupave punuese dhe mbikëqyrjen nga Kuvendi
2025:	Viti i Evropës dhe i ndërkombëtarizimit <ul style="list-style-type: none">- <i>Rruga drejt të ardhmes tonë:</i> Fokusimi në integrimin evropian përmes diplomacisë parlamentare dhe angazhimit me parlamentet e tjera evropiane
2025:	Viti i digjitalizimit <ul style="list-style-type: none">- <i>Realizimi i punës përmes Digjitalizimit:</i> Fokusimi në zhvillimin dhe realizimin e e-parlamentit efikas

MOBILIZIMI I RESURSEVE

Kuvendi i Kosovës është i vetëdijshëm se për zbatimin e Planit Strategjik do të nevojiten burime njerëzore dhe financiare shtesë. Këto do të përcaktohen në bazë vjetore në kuadër të Planit Vjetor të Punës të Administratës në përputhje me Planin Strategjik. Burimet për zbatim mund të rezultojnë nga programe dhe shkëmbime të përbashkëta, ose nga ndihma e drejtpërdrejtë financiare nga donatorët, si dhe nga burimet vetjake nga buxheti i shtetit ose nga alokimi i burimeve të tjera të miratuara. Kuvendi i Kosovës do të vazhdojë të bashkëpunojë me donatorët, në mënyrë që të identifikojë dhe të pajtohet për bashkëpunim për zbatimin me sukses të aktiviteteve që janë në përputhje të plotë me objektivat specifike të paraqitura në këtë Plan.

ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Plani Strategjik për Kuvendin e Kosovës paraqet fushat kryesore me prioritet për zhvillimin strategjik të Kuvendit në periudhën 2022-2025. Në interes të transparencës, ai do të publikohet në ueb- faqen e internetit të Kuvendi, bashkë me Planin Vjetor të Punës së Kuvendit dhe të Administratës dhe raportet vjetore të progresit rreth zbatimit. Plani Strategjik mund të rishikohet ose ndryshohet, nëse e kërkojnë rrethanat.

Kryesia e Kuvendit dhe sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit do të kenë përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e Planit Strategjik të Kuvendit të Kosovës 2022-2025. Roli i udhëheqjes në planifikimin dhe monitorimin e zbatimit do të ushtrohet nga "Grupi për Zbatim, Monitorim dhe Vlerësim të Planit Strategjik" (GZMVPS). Ky përfshin stafin e lartë të Kuvendit të Kosovës, përgjegjës për segmente specifike të këtij plani. GZMVPS-ja, me ndihmën e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, do të hartojë informata të përditësuara me shkrim mbi progresin në baza tremujore, të cilat do të ndahen me Kryesinë e Kuvendit të Kosovës.

GZMVPS-ja do të hartojë një raport vjetor me shkrim që përshkruan progresin e bërë në zbatimin e Planit Strategjik, i cili do të ndahet me të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit po ashtu, do të iniciojë dhe mbështesë një rishikim afatmesëm të Planit Strategjik.

SHTOJCAT

PLANI I VEPRIMIT